

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E KRIVËMINISTRIT - UREDI PREMIJERË - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR			
Njesia Org. Org.Jedimce Org.Unit	01	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.:	1039
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	-02-	Data: Datum: Date:	19/04/2013
Prishtinë / a			

Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve

1. Do të krijohet një Asociacion/Bashkësi e komunave me shumicë Serbe në Kosovë. Anëtarësia do të jetë e hapur për çdo komunë tjetër nëse anëtarët janë në pajtim.
2. Bashkësia/Asociacioni do të themelohet përmes statutit. Shpërbërja e tij mund të bëhet vetëm me vendim të komunave pjesëmarrëse. Do të ketë garanca ligjore përmes ligjit aplikues dhe të drejtës kushtetuese (përfshirë rregullën për shumicën prej 2/3).
3. Struktura e Asociacionit/Bashkësisë do të themelohet mbi të njëjtën bazë si edhe statutit egzistues të Asociacionit të komunave të Kosovës, p.sh. Kryetari, Nënkryetari, Kuvendi, Këshilli.
4. Në përputhje me kompetencat e parapara me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjin e Kosovës komunat pjesëmarrëse do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë në ushtrimin kolektiv të kompetencave të tyre përmes Bashkësisë/Asociacionit. Asociacioni/Bashkësia do të ketë vështrim të plotë mbi fushat si zhvillimi ekonomik, arsimi, shëndetësia, planifikimi urban dhe rural.
5. Asociacioni/Bashkësia do të ushtroj kompetenca të tjera shtesë siç mund të delegohen nga autoritetet qendrore.
6. Bashkësia/Asociacioni do të ketë rol përfaqësues të autoritetet qendrore dhe për këtë qëllim do të ketë një përfaqësues në Këshillin Konsultativ të Komuniteteve. Në përmbushje të këtij roli parashihet funksioni monitorues.
7. Do të ketë një polici në Kosovë e quajtur Policia e Kosovës. E gjithë policia në veri të Kosovës do të integrohen brenda kornizës së Policisë së Kosovës. Pagat do të jenë vetëm nga ana e PK-së.
8. Pjesëtarëve të strukturave serbe të sigurisë do t'u ofrohet vend në strukturat ekuivalente të Kosovës.
9. Do të ketë një Komandant Regjional i Policisë për katër komunat me shumicë serbe në veri (Mitrovica e Veriut, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi). Komandanti i këtij regjioni do të jetë një serb i nominuar nga Ministria e Punëve të Brendshme nga lista e ofruar nga katër kryetarët e komunave në emër të Bashkësisë/Asociacionit. (Do të ketë Komandant tjetër regjional për komunat e Mitrovicës Jugore, Skënderajit dhe Vushtrrisë). Komandanti regjional i katër komunave në veri do të bashkëpunoj me komandantë të tjerë regjional.
10. Autoritetet gjyqësore do të integrohen dhe të veprojnë në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës.
Gjykata e Apelit në Prishtinë do të themeloj një panel të përbërë me shumicë Serbe të Kosovës për të gjykuar të gjitha rastet e komunave me shumicë Serbe.

Një divizion i kësaj Gjykate të Apelit, i përbërë nga staf administrativ dhe gjyqtarë, do të vendoset në mënyrë të përhershme në veri të Mitrovicës (në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës).

Secili panel i divizionit të mësipërm do të ketë përbërje me shumicë të gjyqtarëve S/K. Gjyqtarët përkatës do të vendosen në panel në varësi të natyrës së rastit në fjalë.

11. Zgjedhjet lokale në komunat e veriut do të organizohen në vitin 2013, me lehtësimin e OSBE-së, në përputhje me ligjin e Kosovës, dhe me standardet ndërkombëtare.
12. Një plan zbatimi, i cili përfshin dhe afatin kohorë, do të krijohet deri më 26 Prill. Në zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të trajtohet dhe parimi i financimit transparent.
13. Diskutimet lidhur me Energjinë dhe Telekomun do të intensifikohen nga të dy palët, dhe do të përfundojnë deri më 15 qershor.
14. Është dakorduar që asnjëra palë nuk do të bllokojë, apo inkurajojë të tjerët të bllokojnë, progresin e palës tjetër në rrugën përkatëse drejt BE-së.
15. Do të themelohet një komitet zbatimi nga të dy palët, me lehtësimin e BE-së.

